



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 198, datë 17.04.2024**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...} PËR PERIU DHËN 2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1.A Njohuritë ligjore.

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

*Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruar në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari përpara përcaktimit të fakteve të çështjes pasqyron procedurën e ndjekur nga gjykata dhe vendimet e marra në funksion të zbatimit të saj. Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në të cilën parashtrohet kërkesë padia e paraqitur nga pala paditëse dhe sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin, pakësimin apo saktësimin e objektit të padisë,<sup>1</sup> (ii) vlerësimi i gjykatës lidhur me legjitimitetin aktiv të paditësit<sup>2</sup>. Nuk rezulton që në vendimet e tij gjyqtari të ketë marrë në analizë juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës në shqyrtimin e padive, duke i marrë të mirëqena ato, përsa kohë që nuk janë kundërshtuar nga palët.*

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtari parashton faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i identifikuar ato në pjesën më të madhe të vendimeve burim vlerësimi, në fillim të

---

<sup>1</sup>Vendimi nr.2593, datë 04.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

<sup>2</sup>Vendimi nr.2985, datë 19.09.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

pjesës arsytuese, direkt pas “Vëren”, por jo në një nënpjesë të veçantë. Faktet e çështjes në çdo rast janë paraqitur në mënyrë kronologjike, duke integruar në përmbajtjen e tyre, edhe provat e administruara mbi bazën e të cilave nga gjykata është vlerësuar se provohet fakti konkret, si dhe duke cituar në disa raste edhe pjesë të përmbajtjes së provave shkresore apo në raste të veçanta edhe të provave të tjera, sikurse është ekspertimi. Analiza e fakteve të çështjes mungon vetëm në vendimet në të cilat gjykimi ka përfunduar për shkaqe procedurale (*mosplotësimi të të metave*<sup>3</sup> apo *mospranimi të ankimit për shkak të tejkalimit të afatit*<sup>4</sup>), në të cilat gjyqtari nuk referon dhe analizon elementë të faktit, por merr drejtpërdrejt në analizë shkakun procedural që i ka dhënë fund gjykimit.

***Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes***, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari identifikon dhe përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, pas paraqitjes së rrethanave procedurale, analizës së faktit dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, duke analizuar objektin dhe shkakun e padisë, si dhe përmes gjithë analizës së kuadrit ligjor mbi të cilin themelohet kërkimi. Në këtë kontekst, në lidhje me detyrimin e gjykatës për përcaktimin e saktë të shkakut ligjor të padisë, gjyqtari referon vendimin unifikues nr.3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu evidentohet se përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet duke evidentuar qartë aktin, veprimin, mosveprimin, administrativ, si pasojë e të cilit pala paditëse ka ngritur pretendimet objekt padie duke kërkuar sipas rastit, detyrimin për dëmshpërblim, pavlefshmërinë absolute ose relative të aktit, shfuqizimin e aktit administrativ dhe detyrimin e organit administrativ për të kryer ose mos kryer një veprim administrativ. Në një rast<sup>5</sup>, gjyqtari ka argumentuar se në lidhje me mosmarëveshjen objekt gjykimi gjykata mban parasysh faktin se jemi para një kontrate prokurimi të lidhur mes palëve kontarktuase dhe ndërgjyqëse në gjykim, por nëpërmjet kësaj kontrate janë prokuruar fonde publike dhe si e tillë ajo mbart natyrë specifike dhe të mirërregulluar si nga ligji për prokurimin publik dhe përse është e referueshme edhe në Kodin Civil. Kjo analizë i shërben prezantimit të qartë të natyrës së konfliktit, si dhe orienton në vijim arsyetimi ligjor.

***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm***, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se pas pasqyrimin të fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve në gjykim, gjyqtari ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil, Kodit të Punës dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Konkretisht në vendimet burim vlerësimi, identifikohen, referohen dhe citohen dispozitat me karakter procedural dhe material, si më poshtë:

- nenin 2, 18, 35 dhe 40 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative”, në lidhje me konceptin juridik të aktit administrativ, në funksion të evidentimit të detyrimit të organit të administratës publike për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ, afatin për ngritjen e padisë si dhe disponimin e gjykatës në vendimin e saj përfundimtar<sup>6</sup>;

<sup>3</sup> Vendimi nr.2369, datë 29.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

<sup>4</sup> Vendimi nr.ska, datë 21.09.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

<sup>5</sup> Vendimi nr.377, datë 08.02.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

<sup>6</sup> Vendimi nr.1594, datë 20.04.2017; Vendimi nr.940, datë 20.03.2019; Vendimi nr.1110, datë 03.04.2019; Vendimi nr.4200, datë 02.11.2017; Vendimi nr.775, datë 01.03.2017; Vendimi nr.4803, datë 12.12.2017; Vendimi nr.2593, datë 04.07.2018; Vendimi nr.760, datë 07.03.2019; Vendimi nr.1024, datë 27.03.2019;

- nenin 15 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative”, në lidhje me të drejtën e padisë<sup>7</sup>
- nenet 16 dhe 39 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e momarëveshjeve administrative”, lidhur me ankimin administrativ<sup>8</sup>;
- nenin 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative”, në lidhje me mjetet e ankimit<sup>9</sup>;
- nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative”, lidhur me ankimin ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës me objekt kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundravajtjeve administrative me vlerë më të vogël se njëzetfishi ipagës minimale në shkallë vendi<sup>10</sup>;
- nenin 72/3 të ligjit nr.49/2012, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative”, me qëllim përcaktimin e afatit të paraqitjes së padisë ndaj aktit administrativ<sup>11</sup>;
- nenet 3/1, 4, 5, 98 dhe 108 të K.Pr.Administrative, të cilat normojnë konceptin e aktit adminisrativ, pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, kompetencës administrative dhe territoriale si dhe parimin e ligjshmërisë<sup>12</sup>;
- nenin 112 të K.Pr.Administrative, dispozitë në të cilën është normuar korigjimi i gabimeve materiale<sup>13</sup>;
- nenin 154/a të K.Pr.Civile, lidhur me kriteret juridike të paraqitjes së padisë dhe pasojave juridike të mosplotësimit të këtyre kriterëve<sup>14</sup>;
- nenin 156 të K.Pr.Civile lidhur me detyrimin për pagimin e taksës gjyqësore<sup>15</sup>;
- nenin 254 të K.Pr.Cicvile lidhur me aktin zyrtar me fuqi të plotë provuese<sup>16</sup>
- nenin 443 të K.Pr.Civile lidhur me afatin e ankimit<sup>17</sup>;
- nenin 510, 511 të K.Pr.Civile në lidhje me urdhrin e ekzekutimit<sup>18</sup>;
- nenin 609 të K.Pr.Civile, lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv<sup>19</sup>;
- nenin 420 të K.Civil lidhur me konceptin e detyrimit<sup>20</sup>;

---

Vendimi nr.2985, datë 19.09.2019; Vendimi nr.2298, datë 24.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>7</sup> Vendimi nr.1858, datë 15.05.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>8</sup> Vendimi nr.3215, datë 19.07.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>9</sup> Vendimi nr.ska, datë 21.09.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>10</sup> Vendimi nr.2985, datë 19.09.2019; Vendimi nr.1024, datë 27.03.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>11</sup> Vendimi nr.1282, datë 10.04.2018; Vendimi nr.3152, datë 17.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>12</sup> Vendimi nr.760, datë 07.03.2019; Vendimi nr.1024, datë 27.03.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

<sup>13</sup> Vendimi nr.3215, datë 19.07.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>14</sup> Vendimi nr.2369, datë 29.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

<sup>15</sup> Vendimi nr.2369, datë 29.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>16</sup> Vendimi nr.825, datë 07.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>17</sup> Vendimi nr.ska, datë 21.09.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>18</sup> Vendimi nr.ska, datë 20.01.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>19</sup> Vendimi nr.851, datë 08.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>20</sup> Vendimi nr.4366, datë 03.12.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- nenet 486, 608, 609, 625, 640 të K.Civil, dispozita që normojnë konceptin juridik të dëmit pasuror dhe elementët e detyrueshëm të tij si dhe bazueshmërinë e kërtimeve të paditësit dhe prapësimeve të palës së paditur<sup>21</sup>;
- nenet 143, 144, 145, 153, 155 të K.Punës si ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Citimi i kësaj dispozite ligjore materiale si ligj i zbatueshëm bëhet nga ana e gjyqtarit jo vetëm duke iu referuar pretendimit të palës paditëse mbi kërkimin objekt gjykimi, por duke iu referuar cilësimit të saktë të faktit juridik civil që ka bërë gjyqtari mbi bazën e provave objekt gjykimi<sup>22</sup>;
- nenin 28 të Kodit të Punës<sup>23</sup>.

Gjyqtari identifikon dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, si më poshtë:

- nenet 4, 13, 14 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “*Për kundravajtjet administrative*” lidhur me mënyrën e mbajtjes së procesverbalit të kundravajtjes administrative<sup>24</sup>;
- nenet 32 dhe 62 pika 29 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetejeve*” lidhur me sanksionet në rast të angazhimit të një personi me automjetet në fund të jetës jo në përputhje me kriteret ligjore<sup>25</sup>;
- nenet 13, 45, 46, 53 të ligjit të posaçëm nr.10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, lidhur me procedurën e aktit administrativ të kontestuar nga pala paditëse<sup>26</sup>;
- nenin 2 të ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “*Për trajtimin e veçantë të punojësve që kanë punuar në nëntokë*” lidhur me kriteret e përfitimit të trajtimit të veçantë të punojësve që kanë punuar në nëntokë<sup>27</sup>;
- nenet 2 dhe 3 të ligjit nr.150/2014 “*Për pensionet e punojësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë*”, lidhur me subjektet përfituese të pensionit të pleqërisë për punojësit që kanë punuar në miniera në nëntokë si dhe kushtet e përfitimit të këtij pensioni<sup>28</sup>;
- nenet 57, 58, 60 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” lidhur me përgjegjësinë për masat disiplinore, llojet e tyre si dhe parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masave disiplinore<sup>29</sup>;
- nenet 1, 2, 81, 83 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore të RSH*” lidhur me kontrollin tatimor të subjektit tatimpagues<sup>30</sup> si dhe nenet 122 dhe 125 të këtij ligji lidhur me kundravajtjet administrative<sup>31</sup>;

<sup>21</sup> Vendimi nr.3004, datë 27.07.2018; Vendimi nr.4200, datë 02.11.2017; Vendimi nr.2298, datë 24.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>22</sup> Vendimi nr.1594, datë 20.04.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>23</sup> Vendimi nr.2298, datë 24.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>24</sup> Vendimi nr.4803, datë 12.12.2017; Vendimi nr.1110, datë 03.04.2019; Vendimi nr.1024, datë 27.03.2019; Vendimi nr.2985, datë 19.09.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>25</sup> Vendimi nr.4803, datë 12.12.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>26</sup> Vendimi nr.4803, datë 12.12.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>27</sup> Vendimi nr.4471, datë 07.12.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>28</sup> Vendimi nr.4471, datë 07.12.201 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.:

<sup>29</sup> Vendimi nr.940, datë 20.03.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>30</sup> Vendimi nr.940, datë 20.03.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- ligjin nr.9381, datë 28.04.2005 “Për Kompesimin e Burgimit të Padrejtë”, lidhur me të drejtën për kompesim<sup>32</sup>;
- nenet 30 pika 2, të ligjit nr.602 të Ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, lidhur me të drejtën e ankimit<sup>33</sup>;
- ligjin mbi prokurimin publik duke argumentuar se në kushtet kur jemi para zbatimit të kuadrit ligjor për prokurimet është qartësisht e pranueshme që sjellja e organit publik përgjatë procesit të prokurimit, fazës para lidhjes së kontratës, përgjatë zbatimit të saj dhe zgjidhjes së kontratës është e mirërregulluar nga vetë ligji<sup>34</sup>;
- nenin 3 të ligjit nr.8510, datë 15.07.1999 “Për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore të Organeve të Administratës Shtetërore”, Udhëzimin nr.253, datë 17.01.2017 të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës si dhe Udhëzimin nr.7, datë 15.06.2012 “Për kontrollin e Mjeteve të Transportit në Regjim të Temperaturave të Kontrolluara sipas Marrëveshjes së ATP-së” të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës<sup>35</sup>;
- nenin 22, 23, 27 të ligjit të posaçëm nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” në lidhje me urdhrat e ekzekutimit<sup>36</sup>;
- nenin 34 të ligjit nr.9328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, lidhur me të drejtën e të dënuarve për të punuar<sup>37</sup>;
- nenet 3, 15, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”<sup>38</sup>;
- nenin 77 të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar” lidhur me rimbursimin e tepricës kreditore<sup>39</sup>;
- nenet 106/1, nenin 75/1, 68/1 dhe 68/4 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore të RSH” lidhur me kërkesën për rimbursim, procedurën e shqyrtimit të kësaj kërkesë si dhe kuptimin e vlerësimit tatimor si dhe udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”<sup>40</sup>;
- nenin 30 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, që normon llojet e pensioneve që akordohen nga skema e sigurimeve shoqërore<sup>41</sup>;
- nenet 19, 23, 24, 25 ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me funksionet kryesore të AMA-s, caktimit të pagesave për për lishencat dhe/ose autorizimet e ofruesve të transmetimeve audio dhe shërbimeve të programeve audiovizive si dhe llojet e pagesave<sup>42</sup>;

---

<sup>31</sup> Vendimi nr.1110, datë 03.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>32</sup> Vendimi nr.2978, datë 25.07.201 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.:

<sup>33</sup> Vendimi nr.1282, datë 10.04.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>34</sup> Vendimi nr.377, datë 08.02.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>35</sup> Vendimi nr.3004, datë 27.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>36</sup> Vendimi nr.ska, datë 20.01.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>37</sup> Vendimi nr.4200, datë 02.11.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>38</sup> Vendimi nr.775, datë 01.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>39</sup> Vendimi nr.1858, datë 15.05.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>40</sup> Vendimi nr.1858, datë 15.05.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>41</sup> Vendimi nr.825, datë 07.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>42</sup> Vendimi nr.4366, datë 03.12.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- nenin 11/1 të ligjit nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” lidhur me tarifatat e tjera të shërbimit, përveç atyre të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore<sup>43</sup>;
- nenet 2 dhe 3 të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>44</sup>;
- nenet 53, 63, 55, 46, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, në lidhje me të drejtat e autoritetit kontraktor, procedurën e vlerësimit të ofertave, të drejtën e ankimit të operatorëve ekonomikë etj<sup>45</sup>;
- nenin 92 të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë”, lidhur me ekuivalentimin e diplomave<sup>46</sup>;
- nenet 2 dhe 8, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, në lidhje me objektin dhe projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis<sup>47</sup>;
- nenet 3 dhe 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”<sup>48</sup>;
- nenin 53 të ligjit nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” lidhur me shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga organizatorët e lojërave të fatit si dhe saksionet administrative në këto raste<sup>49</sup>;
- nenin 5 të ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, lidhur me detyrat e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës. Citon VKM-në nr.894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektoriatit kombëtar i mbrojtjes së teritorrit dhe ai i njësisë vendore”<sup>50</sup>;
- nenin 52 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin e territorit” në lidhje me shkeljen e dispozitave në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës<sup>51</sup>.

Krahas dispozitave dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 44 të Kushtetutës, nenin 5/5 dhe 58/5 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtën për t’u zhdëmtuar në rast të dëmtimit nga një veprim apo mosveprim i organit shtetëror<sup>52</sup>;
- nenin 41 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e pronës, mënyrat e fitimit të pronësisë dhe detyrimin për regjistrim<sup>53</sup>;
- nenin 1 të Protokollit të KEDNJ, lidhur me të drejtën e pronës<sup>54</sup>.

<sup>43</sup> Vendimi nr.4366, datë 03.12.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>44</sup> Vendimi nr.2593, datë 04.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>45</sup> Vendimi nr.1482, datë 26.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>46</sup> Vendimi nr.1482, datë 26.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>47</sup> Vendimi nr.1482, datë 26.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>48</sup> Vendimi nr.2593, datë 04.07.2018; Vendimi nr.674, datë 01.03.2019 të i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>49</sup> Vendimi nr.760, datë 07.03.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>50</sup> Vendimi nr.2985, datë 19.09.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>51</sup> Vendimi nr.2985, datë 19.09.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>52</sup> Vendimi nr.2978, datë 25.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>53</sup> Vendimi nr.1282, datë 10.04.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>54</sup> Vendimi nr.3004, datë 27.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

***Sa i përket konfliktit të normave***, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*” në shkallë shumë të lartë, duke u shprehur se “*Çmohet se kam aftësi shumë të lartë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*”.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga analiza e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të kuptueshme të fakteve të çështjes, proces të cilin gjyqtari e arrin nëpërmjet analizës së integruar më vete dhe në tërësi të provave, pavarësisht pretendimeve të palëve mbi rrethanat e faktit. Gjyqtari ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, përcaktimi të cilin e bën në mënyrë të shprehur, duke e referuar si konkluzion të analizës së tij mbi objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Po kështu, rezultojnë aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktet objekt shqyrtimi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.*

### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast, citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarit sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtari kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*), por edhe interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili



duke e përqasur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e tij në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

**- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:**

Në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes evidentohet se interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari interpreton:

- nenin 4 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “*Për kundravajtjet administrative*”, për të dhënë kuptimin e kundërvajtjes administrative dhe elementët e saj gjyqtari interpreton në mënyrë literale<sup>55</sup>;
- nenin 420 të K.Civil lidhur me konceptin e detyrimit<sup>56</sup>;
- nenin 143 të Kodit të Punës lidhur me respektimin e detyrimeve materiale dhe procedurale në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi apo punëmarrësi; nenin 145 të Kodit të Punës me qëllim dhënien e konceptit juridik të shpërblimit për vjetërsi në punë. Në këtë kontekst gjyqtari referon në *vendimin nr.296, datë 10.06.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*, vendim në të cilin janë dhënë konceptet dhe dallimet mes tyre të dëmshpërblimit të lindur nga marrëdhëniet e punës dhe shpërblimit për vjetërsi në punën dhe nenin 153 të Kodit të Punës lidhur me shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës duke referuar në *vendimin unifikues nr.10, datë 15.1.2017 të Gjykatës së Lartë* në funksion të diskrecionit të gjykatës për të caktuar dëmshpërblimin në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar<sup>57</sup>;
- nenet 62 / 29 dhe 32 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*” lidhur me sanksionet në rast të angazhimit të një personi me automjetet në fund të jetës jo në përputhje me kriteret ligjore duke evidentuar dhe natyrën referuese të nenit 62 të këtij ligji<sup>58</sup>;
- nenet 13, 45, 46, 53 të ligjit të posaçëm nr.10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, lidhur me procedurën e nxjerrjes së aktit administrativ të kontestuar nga pala paditëse. Gjyqtari evidenton natyrën referuese të nenit 53 të ligjit 10433/2011 në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “*Për kundravajtjet administrative*” në funksion të analizimit të kriterëve ligjore të mbajtjes së procesverbalit të kundravajtjes administrative<sup>59</sup>;
- nenin 609 të K.Pr.Civile lidhur me padinë për goditjen e titullit ekzekutiv që ngrihet gjatë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv duke u ndalur në mënyrë specifike në rastet kur titulli ekzekutiv është vendim gjyqësor<sup>60</sup>;

---

<sup>55</sup> Vendimi nr.4803, datë 12.12.2017; Vendimi nr.1110, datë 03.04.2019; Vendimi nr.2985, datë 19.09.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>56</sup> Vendimi nr.4366, datë 03.12.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>57</sup> Vendimi nr.1594, datë 20.04.2017:

<sup>58</sup> Vendimi nr.4803, datë 12.12.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

<sup>59</sup> Vendimi nr.4803, datë 12.12.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

<sup>60</sup> Vendimi nr.851, datë 08.03.2018i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

- nenet 2 dhe 3 të ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punojësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, lidhur me subjektet përfituese të pensionit të pleqërisë për punojësit që kanë punuar në miniera në nëntokë si dhe kushtet e përfitimit të këtij pensioni<sup>61</sup>;
- nenet 1, 2, 80, 81, 83 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore të RSH”, lidhur me kontrollin tatimor të subjektit tatimpagues, afatet që normojnë punën e inspektorëve gjatë kontrolleve tatimore si dhe pasojat në rast të mosrespektimit të këtij afati. Këto dispozita interpretohen në raport edhe me nenin 60 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” lidhur me përgjegjësinë për masat disiplinore, llojet e tyre si dhe parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masave disiplinore<sup>62</sup>;
- nenin 122 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore të RSH” lidhur me detyrimin e tatimpaguesit për të lëshuar kupon tatimor<sup>63</sup>;
- nenin 4 dhe 5 të ligjit nr. 9381, datë 28.04.2005 “Për Kompesimin e Burgimit të Padrejtë”, me qëllim për t’i dhënë përgjigje kërimit të palës së paditur për përjashtimin e paditësit nga kompesimi i burgimit të padrejtë si dhe në funksion të argumentit se gjykata nuk mund të akordojë shumën maksimale të kompesimit të padrejtë<sup>64</sup>;
- nenet 60/2 të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluatshme” me qëllim përcaktimin e afatit të ankimit kundër urdhrin të kufizimit të regjistruarit<sup>65</sup>;
- nenet 144,163,192 dhe 193 të Kodit Civil, në lidhje me të drejtën e pronës, mënyrat e fitimit të pronësisë dhe detyrimin për regjistrim<sup>66</sup>;
- nenet 486, 640, 608, 609 të K.Civil, lidhur me konceptin juridik të dëmit pasuror dhe elementët e detyrueshëm të tij<sup>67</sup>;
- nenin 3 të ligjit nr.8510, datë 15.07.1999 “Për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore të Organeve të Administratës Shtetërore” me qëllim analizimin e ekzistencës së ligjshmërisë/paligjshmërisë së veprimeve ose mosveprimeve të palës së paditur<sup>68</sup>;
- nenin 34 të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, dispozitë në të cilën normohen të drejtat dhe dhe trajtimi i të paraburgosurit dhe të dënuarve me burgim, kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente<sup>69</sup>;
- nenin 77 të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar” me nenin 75/1, 68 pika 1 dhe 4 të ligjit “Për procedurat tatimore të RSH” lidhur me kërkesën për rimbursim, procedurën e shqyrtimit të kësaj kërkesë si dhe kuptimin e vlerësimit tatimor<sup>70</sup>;
- nenin 30 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në R.SH” në raport me faktet e çështjes duke argumentuar se mangësitë në mbajtjen dhe administrimin e regjistrave përkatës, në të cilat evidentohen identiteti i punëmarrësit, ditët, vitet e punës nuk mund të

<sup>61</sup> Vendimi nr.4471, datë 07.12.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

<sup>62</sup> Vendimi nr.940, datë 20.03.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

<sup>63</sup> Vendimi nr.1110, datë 03.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

<sup>64</sup> Vendimi nr.2978, datë 25.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

<sup>65</sup> Vendimi nr.1282, datë 10.04.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

<sup>66</sup> Vendimi nr.1282, datë 10.04.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>67</sup> Vendimi nr.3004, datë 27.07.2018; Vendimi nr.4200, datë 02.11.2017; Vendimi nr.2298, datë 24.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>68</sup> Vendimi nr.3004, datë 27.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>69</sup> Vendimi nr.4200, datë 02.11.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>70</sup> Vendimi nr.1858, datë 15.05.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

ngarkojnë me përgjegjësi paditësin pasi nuk është përgjegjësi e tij mbajtja dhe evidentimi i fakteve juridike në regjistrat përkatës, por e organeve publikë, të cilat kanë detyrimin që të mbajnë, evidentojnë dhe pasqyrojnë me saktësi të gjitha të dhënat që kanë lidhje me marrëdhëniet juridike të punës<sup>71</sup>;

- nenet 19, 23, 24, 25 ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me funksionet kryesore të AMA-s, caktimit të pagesave për për lishencat dhe/ose autorizimet e ofruesve të transmetimeve audio dhe shërbimeve të programeve audiovizive si dhe llojet e pagesave<sup>72</sup>;
- nenin 11 pika 1 të ligjit nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” lidhur me tarifatat e tjera të shërbimit, përveç atyre të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore<sup>73</sup>;
- nenet 53, 63, 55, 46, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, në lidhje me të drejtat e autoritetit kontraktor, procedurën e vlerësimit të ofertave, të drejtën e ankimit të operatorëve ekonomikë<sup>74</sup>;
- nenin 92 të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë”, lidhur me ekuivalentimin e diplomave<sup>75</sup>;
- nenin 92 pika 2 të Kodit Rrugor, lidhur me kriteret juridike të lëshimit të lejes së qarkullimit<sup>76</sup>;
- nenet 2 dhe 8, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, në lidhje me objektin dhe projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis<sup>77</sup>;
- nenin 3 dhe 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me qëllim analizimin e të drejtës së çdo personi për tu njohur me informacionin publik dhe detyrimin e autoritetit publik për të informuar kërkuesin nëse e ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar<sup>78</sup>;
- nenin 53 të ligjit nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” lidhur me shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga organizatorët e lojërave të fatit si dhe saksionet administrative në këto raste<sup>79</sup>;
- nenin 5 të ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, lidhur me detyrat e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës;
- nenin 15 të ligjit nr.8402, datë 10.08.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimve të ndërtimit” lidhur me shkeljen e dispozitave në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës me nenin 52 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin e territorit”<sup>80</sup>

Në lidhje me normat procedural, gjyqtari ka interpretuar dispozitat në disa raste, si më poshtë:

- interpreton nenin 72 / 3, të ligjit nr.49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative”, në lidhje me afatin e paraqitjes së padisë duke analizuar natyrën referuese

---

<sup>71</sup> Vendimi nr.825, datë 07.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>72</sup> Vendimi nr.4366, datë 03.12.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>73</sup> Vendimi nr.4366, datë 03.12.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>74</sup> Vendimi nr.1482, datë 26.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>75</sup> Vendimi nr.1482, datë 26.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>76</sup> Vendimi nr.1482, datë 26.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>77</sup> Vendimi nr.1482, datë 26.04.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>78</sup> Vendimi nr.674, datë 01.03.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>79</sup> Vendimi nr.760, datë 07.03.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>80</sup> Vendimi nr.2985, datë 19.09.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

të kësaj dispozite në ligje të veçanta, konkretisht në ligjin nr.33/2012 “Për regjistrimin ne pasurive të paluatshme”<sup>81</sup>;

- nenet 2 dhe 18 të ligjit nr.49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative”, me qëllim dhënien e konceptit të aktit administrativ dhe përcaktimin e afatit të paraqitjes së padisë ndaj aktit administrativ si dhe mbi afatit e paraqitjes në gjykatë të padisë administrative duke analizuar faktet e çështjes<sup>82</sup>;
- nenin 15 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative”, në lidhje me të drejtën e padisë duke argumentuar se për shkak se veprimi/mosveprimi i organeve tatimore (*mosveprimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë për rimbursimin e shoqërisë*) nuk është goditur gjyqësisht atëherë gjykata nuk mund të rregullojë pasojat juridike që ka prodhuar kjo mosveprimtari/veprimtari administrative e për rrjedhojë është disponuar për rrëzimin e këtij kërkimi<sup>83</sup>;
- nenin 16 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e momarëveshjeve administrative”, lidhur me shterimin e ankimit administrativ<sup>84</sup>;
- nenin 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e momarëveshjeve administrative” me nenin 443 të K.Pr.Civile lidhur me mjetet dhe afatin e ankimit<sup>85</sup>;
- nenin 154/a të K.Pr.Civile, lidhur me kriteret juridike të paraqitjes së padisë dhe pasojave juridike të mosplotësimit të këtyre kriterëve<sup>86</sup>;
- nenin 108/a të K.Pr.Administrative, në të cilën normohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ, kur ky i fundit është nxjerrë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të K.Pr.Administrative dhe legjisllacionit në fuqi; nenin 3/5 të K.Pr.Administrative lidhur me kompetencën administrative dhe territoriale të organit të administratës publike<sup>87</sup>;
- nenin 112 të K.Pr.Administrative, lidhur me korrigjimin e gabimeve materiale dhe referon në *parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, pasi gjykata nuk mund të marrë rolin dhe atributin e organit administrativ, i cili ka nxjerrë aktin administrativ objekt ndreqje gabimi. Gjyqtari argumenton se asnjë organ apo institucion tjetër në përbërje ose jo të tri pushteteve (*legjisllativ, ekzekutiv, gjyqësor*) nuk mund të ndërhyjnë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qëndror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera. Në këtë aspekt gjyqtari referon në *vendimin nr.11, datë 02.04.2008 dhe nr.19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*<sup>88</sup>;
- nenin 35 të ligjit nr.45/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykata administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative” në lidhje me detyrimin procedural të organit publik për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ si dhe afatin për ngritjen e padisë<sup>89</sup>;
- nenin 18/1 të ligjit nr.45/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykata administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative” lidhur me afatin ligjor për ngritjen e padisë kundër veprimit administrativ<sup>90</sup>.

---

<sup>81</sup> Vendimi nr.1282, datë 10.04.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>82</sup> Vendimi nr.1282, datë 10.04.2018; Vendimi nr.3152, datë 17.07.2017; Vendimi nr.760, datë 07.03.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>83</sup> Vendimi nr.1858, datë 15.05.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>84</sup> Vendimi nr.3215, datë 19.07.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>85</sup> Vendimi nr.ska, datë 21.09.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>86</sup> Vendimi nr.2369, datë 29.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>87</sup> Vendimi nr.760, datë 07.03.2019; Vendimi nr.1024, datë 27.03.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>88</sup> Vendimi nr.3215, datë 19.07.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>89</sup> Vendimi nr.4200, datë 02.11.2017; Vendimi nr.2298, datë 24.05.2017; Vendimi nr.2593, datë 04.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në disa nga vendimet janë interpretuar dispozitat kushtetuese apo të Konventave ndërkomëtare:

- nenet 58 pika 5 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut me nenin 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>91</sup>;
- nenet 41 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e pronës, mënyrat e fitimit të pronësisë dhe detyrimin për regjistrim<sup>92</sup>;
- nenin 18 të Kushtetutës me nenin 14 të KEDNJ-së dhe ligjin nnr.10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, me qëllim dhënien e konceptiti të diskriminimit dhe shkaqeve të tij<sup>93</sup>;
- nenin 23 të Kushtetutës me nenin 3 të ligjit nr.119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, me qëllim dhënien e konceptiti të diskriminimit dhe shkaqeve të tij<sup>94</sup>.

Në disa nga vendimet janë interpretuar dispozita të akteve nënligjore që gjejnë zbatim. Konkretisht, gjyqtari:

- interpreton pikën 106.1 të udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” në funksion të argumentimit se vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor nuk shkakton efekte juridikepër tatimpaguesin individualisht dhe për rrjedhojë nuk mund të bëhet objekt i shqyrtimit gjyqësor<sup>95</sup>;
- interpreton në mënyrë të përgjithshme VKM-në nr.894, datë 04.11.2015 “*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektoriai kombëtar i mbrojtjes së teritorrit dhe ai i njësisë vendore*”<sup>96</sup>;
- pikën 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.37, datë 03.09.2015 “*Për gjobat për dëmtime në rrjetin rrugor dhe hapësirat e gjelbra të Bashkisë së Tiranës dhe metoda e vlerësimit të dëmit*”<sup>97</sup>

***Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante***, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- vendimin nr.24, datë 12.11.2018 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me parimin e “*gjësë së gjykuar*” duke evidentuar se ky parim përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimin e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkuese-arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe ti përkasin fakteve ose marëdhënieve që kanë formuar objektin mbi të cilën gjykata ka dhënë vendimin e saj<sup>98</sup>;

---

<sup>90</sup> Vendimi nr.775, datë 01.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>91</sup> Vendimi nr.2978, datë 25.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>92</sup> Vendimi nr.1282, datë 10.04.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>93</sup> Vendimi nr.4200, datë 02.11.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>94</sup> Vendimi nr.775, datë 01.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>95</sup> Vendimi nr.1858, datë 15.05.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>96</sup> Vendimi nr.2985, datë 19.09.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>97</sup> Vendimi nr.1024, datë 27.03.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>98</sup> Vendimi nr.851, datë 08.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- vendimet nr.20, datë 15.04.2015, nr.3/2018, nr.25, datë 28.04.2014, nr.10, datë 13.02.2017, nr.11/2018 të Gjykatës Kushtetuese me qëllim analizimin e parimit të “Sigurisë juridike”<sup>99</sup>;
- vendimin unifikues nr.7, datë 01.06.2011 të Gjykatës së Lartë, me të cilin është unifikuar praktika ligjore se punëmarrësi nuk mund të ngrejë padi për goditjen e aktit administrativ, por mund të ngre padi për kërkimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës<sup>100</sup>;
- vendimin unifikues nr.3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me detyrimin e gjykatës për të vlerësuar dhe marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të jap një vendim lidhur me to<sup>101</sup>;
- vendimin unifikues nr.1, datë 29.02.2016 të Kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë, në funksion të përfundimit se kur punojësi i Policisë së Shtetit ka mbajtur dhe është paguar për gradën policore të cilën më pas ai kundërshton, konsiderohet se ai ka marrë dënimin për gradën që kundërshtohet<sup>102</sup>;
- vendimin unifikues nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me barrën e provës së paditësit për provuar ekzistencën e dëmit konkret të pretenduar<sup>103</sup>;
- vendimet e GJEDNJ-së konkretisht vendimin *Brumarescu vs. Romania nr.28342/95*, *Ryabyh vs. Russia, nr.52854/99 si dhe Rosca vs. Moldavia, nr.6267/02* me qëllim analizimin e parimeve të “shtetit të së drejtës” dhe “sigurisë juridike” ku referon edhe në vendimin nr.2, datë 29.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese<sup>104</sup>;
- referon në çështjen *Radchikov vs. Rusisë të GJEDNJ* në funksion të argumentit se organet publike kanë detyrimin që të mbajnë, evidentojnë dhe pasqyrojnë me saktësi të gjitha të dhënat që kanë lidhje me marrëdhëniet juridike të punës dhe me legjislacionin përkatës të sigurimeve shoqërore<sup>105</sup>.

***Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës***, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton gjyqtari zbaton parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi referuar kontekstit të arsyetimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejtë aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, aksesin në gjykatë, kontradiktorialitetin, të drejtën e disponimit të padisë, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim, etj. Në vendimet burim vlerësimi ka analizë të ligjshmërisë, parimit të sigurisë juridike dhe të gjësë së gjykuar, duke evidentuar se ky parim përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimin e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe ti përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin mbi të cilën gjykata ka dhënë vendimin<sup>106</sup> etj.

<sup>99</sup> Vendimi nr.4471, datë 07.12.2018; Vendimi nr.3004, datë 27.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>100</sup> Vendimi nr.1594, datë 20.04.2017; Vendimi nr.2593, datë 04.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>101</sup> Në shumicën e vendimeve object vlerësimi.

<sup>102</sup> Vendimi nr.3152, datë 17.07.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>103</sup> Vendimi nr.4200, datë 02.11.2017; Vendimi nr.2298, datë 24.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>104</sup> Vendimi nr.851, datë 08.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>105</sup> Vendimi nr.4471, datë 07.12.2018; Vendimi nr.3004, datë 27.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>106</sup> Vendimi nr.760, datë 07.03.2019; Vendimi nr.1024, datë 27.03.2019; Vendimi nr.851, datë 08.03.2018; Vendimi nr.4471, datë 07.12.2018; Vendimi nr.3004, datë 27.07.2018 etj

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se “Çmoj se kam aftësi shumë të lartë për të indentifikuar ligjin e aplikueshëm dhe arsytimin e tij për mënyrën e zbatimit mbi faktet objekt gjykimi. Krahas identifikimit të ligjit të aplikueshëm, çmoj se kam aftësi shumë të lartë për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale dhe procedurale që kanë lidhje me intepretimin e ligjit dhe zgjidhjen e çështjes. Po kështu, cmoj se kam aftësi shumë të lartë për përdorimin e jurisprudencës relevante vendase dhe ndërkombëtare, i praktikës së unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë, praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ-së.”

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuar, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të zbatuar, referuar dhe kur është rasti për të analizuar aspektet të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Në disa nga çështjet brumi vlerësimi, gjyqtari ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ në mbështetje të argumenteve të tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.*

## **1.B Arsyetimi ligjor**

### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato

janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar<sup>107</sup>.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në kllapa), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.<sup>108</sup> Termat teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm, duke ju referuar ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që zbatohen mbi marrëdhënien objekt gjykimi.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fytes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare dhe shpesh herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Vendimet janë të organizuar në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit dhe shpesh identifikohen me fjali tematike.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria e vendimit*” në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se “*Në respektim të një prej parimeve themelore të procesit gjyqësor, sic është ai i përdorimit të gjuhës shqipe në gjykim, cmoj se kam aftësi shumë të lartë për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën shqipe, duke shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë, duke zbatuar saktë rregullat gramatikore dhe atyre të sintaksës, përzgjedhjen e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimin i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip. Po kështu organizoj paragrafët dhe strukturën e fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimin në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë, me qëllim që vendimi gjyqësor të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në*

<sup>107</sup> Vendimi i GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

<sup>108</sup>P.sh : *ratione loci; ratione personae; ratione materia; ratione temporis; omnis probandi; de facto, de jure; etj.*



*përmbajtje, ku në tërësinë e tij ai të jetë një unitet, në të cilin pjesët përbërëse të jenë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato janë në shërbim dhe funksion të njëra tjetrës”*

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë e vendimi tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej tij për zgjidhjen, apo zgjidhjen tërësorë të çështjes.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.***

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjore, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që juristës/ gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet në çdo rast, duke filluar me prezantimin e fakteve, duke e gërshetuar me provat e lejuara për shqyrtim, identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ka një metodologji të tij të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke i ndarë me paragrafë, të cilat vijnë në rrjedhë kronologjike dhe logjike midis njëri-tjetrit, megjithëse nuk i ndanë të gjitha vendimet në nënpjesë me fjali përshkruese, nga përmbajtja e tyre identifikohet qartë secila pjesë e tij. Në disa vendime konstatohet se gjyqtari e ndaj pjesën përshkruese - arsytuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen

e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese – arsyetuese (e ndarë në paragrafë, të cilët vijjnë njëri pas tjetrit, duke filluar me rrethanat e faktet e provuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pretendimet e palëve, pasqyrimin e ligjit të zbatueshëm dhe në analizën juridike), si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre (*me të dhënat për gjeneralitetet, adresën dhe përfaqësimin në gjykatë*), prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i mosmarrëveshjes administrative, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, në të cilën në mënyrë të detajuar gjyqtari:

- (i) ndalet paraqitjen e padisë nga ana e paditësit, në analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me evidentimin e vendimmarrjeve të ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. kërkesa për marrjen e masës ë sigurimit të padisë, shtimin e ndërgjyqësisë pasive, apo ndryshimin/pakësimin e objekti të padisë, etj.
- (ii) *faktet dhe rrethanat e provuara në gjykim*, pjesë në të cilën gjyqtari përshkruan dhe analizon faktet thelbësore të çështjes, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim së bashku me analizën e tyre, duke ndjekur kryesisht një rend kronologjik në paraqitjen e faktit, siç ka rezultuar i provuar në gjykim.
- (iii) *pretendimet dhe prapësimet e palëve*, pjesë në të cilën gjyqtari parashton pretendimet dhe prapësimet e secilës palë duke argumentuar përgjigjet për çdo kërkim.
- (iv) *kuadri ligjor dhe zgjidhja juridike e çështjes*, në të cilën gjyqtari fillimisht citon ligjin material e procedural që zbatohen në çështjen konkrete, duke i referuar dispozitat materiale administrative dhe civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik, merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin e tij abstrakt, parapara aplikimit mbi faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), mbi ekzekutueshmërinë e vendimit nga zyra përbarimore për vendimet e pranimit që përmbajnë detyrimi, si dhe disponimin mbi shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi disponohet për të drejtën e ankimit sipas afateve ligjore ose për cilësinë e vendimit si i paankimueshme.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit*” në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se: “*Çmoj se kam aftësi shumë të lartë për të hartuar vendimet gjyqësore duke ndjekur dhe respektuar strukturën e përcaktuar në nenin 310 të Kodit të Procedurë. Konkretisht, duke përcaktuar gjykatën që ka gjykuar çështjen, palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, objekti i padisë, kërkimet përfundimtare të palëve, rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi, dispozitat ligjore në të cilat bazohet*

*vendimi, si dhe pjesën urdhëruese të këtij vendimi, me qëllim që vendimi gjyqësor të konsiderohet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje.”*

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme më shumë në aspektin e përmbajtjes, por jo atë vizual ( pjesa më e madhe e vendimit është ndarë vetëm në paragrafë dhe jo në tituj apo fjali hyrëse përshkuese), por duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

### **1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.**

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjyqtarëve u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, për sa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.<sup>109</sup>

### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se vendimet gjyqësore dominohen nga proces analitik dhe vlerësues në raport me atë përshkruar të fakteve dhe provave. Gjyqtari ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj edhe provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit për provueshmërinë e fakteve konkrete. Gjyqtari zhvillon analizën juridike për secilin kërkim të ngritur në kërkesëpadi (*ose pasi ka parashtruar çështjet/pyetjet ligjore për diskutim*), ku gjithmonë integron analizën e lidhjes shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, ligjit përkatës dhe mënyrën e aplikimit të tij në rrethanat konkrete, për të konkluduar mbi zgjidhjen përkatëse.

<sup>109</sup>Vendimi i GJEDNJ, çështja “Hadjanastassiou kundër Greqisë”.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim funksional dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe atë material. Evidentohet gjithmonë kujdesi i gjyqtarit në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

*Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve*, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u parashtruar në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit dhe më pas duke u marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre, në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimin konkret. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsyetimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçantë të arsyetimit, pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme, si pjesë e arsyetimit të vendimit. Në disa vendime gjyqësore argumenti rrjedh nga çështja apo pyetja ligjore e parashtruar nga ana e gjyqtarit për zgjidhje dhe hap pas hapi evidentohet logjika me të cilin gjyqtari i përgjigjet çështjes.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin "*cilësia e analizës dhe argumentimit logjik*" në shkallë shumë të lartë, duke u shprehur se: "*Vlerësoj se gëzojë aftësi shumë të lartë për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar, duke arsyetuar qartë dhe saktë me qëllim që niveli i arsyetimit të plotësojë standardin e procesit të rregullt ligjor, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve.*"

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin "*Cilësia e analizës dhe argumentit logjik*". Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, dhe në disa raste për të mbështetur interpretimin e tij ka referuar në qëndrimeve të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe atë të GJEDNJ. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara kryesisht për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për treguesin "*Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik*" vlerësohet "*Shumë e lartë*" dhe pikëzohet me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore, për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 206 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi (171 çështje në vitin 2017, 17 çështje në vitin 2018 dhe 18 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin dy kategorive “Administrative me palë kundërshtare” dhe “Administrative pa palë kundërshtare”.

Duke iu referuar objektit të çështjeve pasqyruar në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet janë me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbartimore” për të cilat neni 610 paragrafi i tretë<sup>110</sup> i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se çështja duhet të shqyrtohet brenda një afati 20 ditor, dhe me objekt “Sigurim padie”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 28, pika 3 të ligjit nr.49/2012<sup>111</sup> duhet të shqyrtohen brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 206 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 99 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (99 çështje), me numrin total të

<sup>110</sup>Neni 69 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se “Veprimet e kryerja nga përmbartuesi gjyqësor, në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, ankimohen sipas parashikimeve të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile”. Ndërkohë neni 610 pg. 3 i K.Pr.Civile, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2016, datë 3.11.2016, parashikon se: “Ankimi shqyrtohet **brenda 20 ditëve** nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbartuesin gjyqësor”.

<sup>111</sup>Neni 28 pika 3 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon se “Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet **brenda 5 ditëve** nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në rastet e ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët”.

çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (206 çështje), **sipas një analize vetëm matematikore, gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 48% të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit.

Në përlllogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, përlllogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarit), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlllogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët apo 35 ditë kalendarike);
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve, 6 ditë ;

Kështu, referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton si vijon:

Për vitin 2017 rezulton se:

- në tabelën nr. 2, 54 çështjet me objekt *“Lëshim urdhër ekzekutimi”*<sup>112</sup>, me nr. rendor 9-18, 20, 22, 26-29, 32, 40, 45, 47, 48, 51, 57, 61, 66, 69-72, 76-81, 95-97, 99-105, 112, 129-135 dhe 138 janë gjykuar për 7 ditë, 5 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 4 ditë, 4 ditë , 4 ditë , 4 ditë , 4 ditë , 5 ditë , 7 ditë, 5 ditë,, 5 ditë , 5 ditë , 5 ditë, 5 ditë 3 ditë, 3 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 5 ditë, 4 ditë, 5 ditë, 5 ditë, 6 ditë, 5 ditë, 5 ditë , 5 ditë , 3 ditë, 4 ditë, 4 ditë, 4 ditë, 4 ditë, 5 ditë, 5 ditë , 5 ditë , 5 ditë, 7 ditë, 6 ditë, 6 ditë, 6 ditë, 6 ditë, 5 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 6 ditë dhe 5 ditë. Tejkalimi i afatit me 1-2 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështjet do të vlerësohen si të gjykuara **brenda afatit 5 ditor të parashikuar nga ligji.**

Për vitin 2018 rezulton se:

- në tabelën nr.2, 4 çështjet me objekt *“Sigurim padie”*<sup>113</sup>, me nr. rendor 175, 176, 184 dhe 185 janë gjykuar për 6 ditë, 5 ditë, 4 ditë dhe 5 ditë. Tejkalim i afatit me 1 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të vlerësohen të gjykuara **branda afatit 5 ditor të parashikuar nga ligji.**

Për vitin 2019 rezulton se:

---

<sup>112</sup> Neni 510 i K.Pr.Civile përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr.38/2017, parashikonte afatin 5 ditor të shqyrtimit të kërkesave me objekt lëshim urdhëri ekzekutimi. Kështu do të konsiderohen me afat ligjor, kërkesat e regjistruara para datës 06.11.2017, duke qenë se ligji nr.38/2017, «Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, «Kodi i Procedures Civile në RSH», të ndryshuar, ka hyrë në fuqi me dt.05.11.2017 (gjashtë muaj pas botimit në fletoren zyrtare, i cili rezulton se është botuar në Fletoren Zyrtare nr.98, viti 2017, datë 05.05.2017.

<sup>113</sup> Neni 28/3 e ligjit nr.49/2012 parashikon afat 5 ditor të shqyrtimit të kërkesës për sigurim padie.

- në tabelën nr. 1, çështja me objekt “*Kundërshtim veprimesh përmbarimore*”<sup>114</sup> me nr. rendor 204 është shortuar me datë 14.08.2019 dhe ka përfunduar me datë 12.09.2019, pra është gjykuar për 30 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e përfunduar për 7 ditë, pra **brenda afatit ligjor 20 ditor të parashikuar nga ligji.**
- në tabelën nr.2, 2 çështjet me objekt “*Sigurim padie*”<sup>115</sup>, me nr. rendor 174 dhe 181 janë gjykuar të dyja për 7 ditë. Tejkalim i afatit me 2 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të vlerësohen të gjykuara **branda afatit 5 ditor të parashikuar nga ligji.**

Për pasojë, duke konsideruar shpjegimet e mësipërme **61 çështjet e mësipërme do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor.**

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore si dhe çështjeve të analizuara më sipër, rezultoi se numri i çështjeve me afat ligjor është 206 çështje. Po ashtu në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (99 çështje), duhet të zbriten edhe 61 çështje, pasi referuar analizës për secilën prej tyre, rezultoi se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor. Në këtë mënyrë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (38 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (206 çështje), rezulton të jetë 18.4%, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 12 pikë (11-20% - 12 pikë).

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtari ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (01.01.2017 - 31.12.2019), 1741 çështje, nga të cilat 1104 çështje janë me palë kundërshtare dhe 637 çështje pa palë kundërshtare.

Referuar standardit sasior në fuqi<sup>116</sup>, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 150 çështje me palë kundërshtare në vit. Në rastin konkret, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar 1104 me

<sup>114</sup> Nenin 610 i K.Pr.Civile në fuqi parashikon afatin ligjor 20 ditor të shqyrtimit të këtyre padive.

<sup>115</sup> Neni 28/3 e ligjit nr.49/2012 parashikon afat 5 ditor të shqyrtimit të kësaj kërkesë.

palë kundërshtare, ose 654 çështje më shumë seç është e përcaktuar në Vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së, duke e kaluar standardin sasior me thujse 145 %.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Respektimi i afateve ligjore*” në shkallë shumë të lartë, duke u shprehur se “*Ligji nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative Dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” nuk parashikon afate ligjore për përfundimin e çështjeve administrative. Ligji nr.49/2012 parashikon për kryerjen e veprimeve procedurale, si përshembull neni 25 parashikon afatin 7 ditor për vënien e çështjes në lëvizje.*

*Neni 399/2 i Kodit të Procedures Civile, parashikon afatin e arsyeshem për përfundimin e gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij.*

*Nga të dhënat në çdo rast është respektuar afati i gjykimit, veprimeve procedurale te vecanta dhe dorezimit te dosjes.”.*

Ndërsa kryetari i gjykatës e ka vlerësuar treguesin “*respektimi i afateve ligjore*” në shkallë shumë të lartë.

## KONKLUZIONI

*Në tërësi*, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të lartë për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (*1 deri në 2 ditë*) si dhe zbritet koha gjatë se cilës gjyqtari ka kryer lejen vjetore, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 38 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (38 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (206 çështje), rezulton të jetë **18.4 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor**, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me 12 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkallim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 18.4 % (ii) ngarkesën e gjyqtarit si relator (*në total ka gjykuar 1741 çështje, nga të cilat 1104 me palë kundërshtare*), faktin se ai e ka tejkaluar standardin sasior mesatare me thujse 145%, gjyqtari për këtë tregues duhet të vlerësohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i korespondon të dhënave statistikore, duke e pikëzuar me 15 pikë.

---

<sup>116</sup> Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, të ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja c), parashikohet se “*Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit administrativ, jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative*”.



*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i afateve ligjore” është shumë e lartë, brenda marzhit “0-10 %”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, duke iu referuar standardit minimal kohor 1 muaj të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së,<sup>117</sup> rezulton se nga **1535** çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, **814**<sup>118</sup> prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë **53%** të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi. Në fakt në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, nuk rezulton të jetë përcaktuar standardi minimal kohor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e administrative të shkallës së parë, por afate gjykimi të shqyrtimit të këtyre mosmarrëveshjeve nga seksioni administrativ, që funksiononte në atë kohë.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10 ditor për depozitimimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezultojnë se veprimet përgatitore që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë zgjatën mesatarisht 47 ditë.

<sup>117</sup>Në pikën 5 shkronja “c” të “Kritereve matëse të veprimtarisë së gjyqësore”, miratuar me vendimin e KLD nr.261/2 të vitit 2010, lidhur me standardin minimal kohor për gjykimin e çështjeve administrative, parashikohet se: “Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë: ...c. Gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo me tej se 1 muaj.”.

<sup>118</sup>Në vendimin nr. 60, datë 30.01.2020 të KLGJ “Për miratimin e udhëzuesit për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” përcaktohet se për çështjet që nuk kanë afat ligjor gjykimi, afati i përfundimit të gjykimit është periudha kohore nga data e shortit të përzgjedhjes së gjyqtarit relator subjekt vlerësimi deri në datën e shpalljes së vendimit. Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë rezultojnë se afati i përfundimit të gjykimit është përllogaritur nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, gjë e cila nga ndikuar në përcaktimin e gabuar të kohës së përfundimit të gjykimit.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, caktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15 ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seance gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.Civile për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, dhe afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 308 të K.Pr.Civile për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, **gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh.** Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues në fuqi.

Respektimi strikt i afateve të parashikuara nga ligji nr.49/2012 dhe Kodi i Procedurës Civile, sjell një kohëzgjatje gjykimi të çështjeve më shumë se 1 (një) muaj nga ajo e përcaktuar si standard orientues, e si i tillë ky i fundit nuk ka kuptim të gjejë zbatim.

Referuar afatit 87 ditor të llogaritur më lart, si kohë e domosdoshme për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, rezulton sa më poshtë:

Për vitin 2017 rezulton se:

- në tabelën nr. 1, **199** çështjet me palë kundërshtare, me nr. rendor 1-5, 7-9, 14-18, 20-24, 27, 30, 32-34, 39-50, 53, 54, 56, 60, 62, 64, 67-70, 75, 78, 82-86, 88-90, 92-96, 100-102, 104, 109-112, 116-119, 121, 123, 125-127, 129, 131-141, 144, 145, 148, 149, 154, 157, 158, 160-164, 166, 168, 169, 171, 173, 177, 181, 184-186, 189, 190, 192, 193, 198-202, 205, 208, 210, 211, 214-216, 220-223, 228, 237, 239, 241, 245, 246, 248-250, 252, 254, 255, 257, 261, 266-270, 273-275, 277-279, 283-287, 289-291, 295, 301, 302, 305, 306, 308, 310-316, 319, 321-323, 326-331, 333, 334, 338-340, 342, 346-348, 350, 352, 360, 363, 364, 367, 370, 372-374, 376, 380, 382 dhe 386 **rezultojnë të gjykuara në më pak se 87 ditë.**
- po në tabelën 1, **17** çështjet me palë kundërshtare me nr. rendor 28, 76, 98, 130, 187, 191, 203, 272, 282, 292, 304, 336, 337, 351, 353, 356 dhe 357 rezultojnë të gjykuara mbi 87 ditë. Por, duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, apo kohën e mbartjes së dosjeve dhe duke konsideruar të papërfillshëm tejkalimin e afatit deri me 5 ditë (çështjet me nr. 28, 76, 98, 187, 191, 203 dhe 353) çështjet do të konsiderohen të përfunduara **brenda afatit 87 ditor.**
- Në tabelën nr. 2, **7** çështjet pa palë kundërshtare me nr. rendor 175, 182, 186, 189, 194, 195 dhe 196 rezultojnë të gjykuara në më pak se 60 ditë (2 muaj).

- Në tabelën 3, **28** çështjet me palë kundërshtare “*Marrëdhënie pune*”, me nr. rendor 1, 2, 4-7, 9-17, 19-26, 29, 30, 36, 38-39 **rezultojnë të gjykuara në më pak se 87 ditë.**
- Po në tabelën 3, çështja me nr. rendor 37 rezulton e gjykuar për 94 ditë. Por, duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështja do të konsiderohet e përfunduar **brenda afatit 87 ditor.**

**Në total për vitin 2017 janë gjykuar brenda këtij afati, 252 çështje.**

Për vitin 2018 rezulton se:

- në tabelën nr. 1, **190** çështjet me palë kundërshtare, me nr. rendor 1, 4, 6, 7, 10, 12, 17-25, 31, 33, 34, 37-39, 41, 43-46, 48, 49, 52, 54, 55, 58, 59, 62, 63, 65, 66, 70, 72, 75, 77, 79-81, 83, 86, 88, 90-92, 95-105, 107, 110, 113, 115, 116, 122, 124-126, 128, 130-133, 136, 139, 140, 142-146, 148, 150, 152-154, 157-160, 163, 164, 166, 168-170, 172, 173, 175, 177, 179-181, 184, 186-188, 190-192, 194, 197-199, 203, 205, 207-209, 211-2014, 216, 218, 220, 222-224, 229-237, 243-245, 249, 251, 253-255, 258, 260, 261, 264, 266, 269, 273-276, 280, 281, 285, 287, 293, 295, 297-300, 304-309, 311, 315, 316, 319, 322-324, 331-335, 337, 339, 343 dhe 344 **rezultojnë të gjykuara në më pak se 87 ditë.**
- po në tabelën 1, **14** çështjet me palë kundërshtare me nr. rendor 5, 11, 29, 151, 225, 228, 259, 263, 267, 277, 282, 296, 301 dhe 345 rezultojnë të gjykuara mbi 87 ditë. Por, duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, apo kohën e mbartjes së dosjeve dhe duke konsideruar të papërfillshëm tejkalimin e afatit deri me 5 ditë (çështjet me nr. 5, 11, 29, 151 dhe 345) çështjet do të konsiderohen të përfunduara **brenda afatit 87 ditor.**
- Në tabelën nr. 2, **13** çështjet pa palë kundërshtare me nr. rendor 102-108, 169, 175, 176, 184, 185 dhe 211 rezultojnë të gjykuara në më pak se 60 ditë (2 muaj).
- Në tabelën 3, **6** çështjet me palë kundërshtare “*Marrëdhënie pune*”, me nr. rendor 1, 2, 5, 6, 8 dhe 9 **rezultojnë të gjykuara në më pak se 87 ditë.**
- Po në tabelën 3, çështja me nr. rendor 3 rezulton e gjykuar për 88 ditë. Tejkalimi me 1 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështja do të konsiderohet e përfunduar **brenda afatit 87 ditor.**

**Në total për vitin 2018 janë gjykuar brenda këtij afati 224 çështje.**

Për vitin 2019 rezulton se:

- në tabelën nr. 1, **148** çështjet me palë kundërshtare, me nr. rendor 2-4, 6, 8, 11, 12, 15-18, 20, 22-24, 29, 31-34, 38, 39, 42, 43, 45-47, 50, 53-55, 58, 61, 64, 70-72, 76-78, 84-88, 91, 93, 94, 98, 99, 103, 107, 110, 112, 116, 118, 122-124, 128, 130, 132, 134, 135, 141, 142, 144, 145, 148-150, 152-154, 158, 160, 163-169, 172, 174, 176, 178, 181, 182, 184, 186, 189, 191, 194, 197-200, 202, 207-211, 213, 217-221, 224, 227-237, 239, 242, 243, 247, 249-251, 255, 256, 261, 264, 265, 267-269, 272, 277, 278, 281, 282, 286-288, 290, 291, 293-295, 298-303, 308 dhe 309 **rezultojnë të gjykuara në më pak se 87 ditë.**
- po në tabelën 1, **17** çështjet me palë kundërshtare me nr. rendor 57, 100, 188, 201, 212, 215, 216, 238, 240, 248, 257, 259, 260, 263, 266, 270 dhe 289 rezultojnë të gjykuara mbi 87 ditë. Por, duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, apo kohën e mbartjes së dosjeve dhe duke konsideruar të papërfillshëm tejkalimin e afatit deri me 6 ditë (çështjet me nr. 100, 188, 201, 266 dhe 289) çështjet do të konsiderohen të përfunduara **brenda afatit 87 ditor.**

- Në tabelën nr. 2, **10** çështjet pa palë kundërshtare me nr. rendor 66, 103-107, 166, 168, 169 dhe 171 rezultojnë të gjykuara në më pak se 60 ditë (2 muaj).
- Në tabelën 3, **8** çështjet me palë kundërshtare “*Marrëdhënie pune*”, me nr. rendor 1, 3, 4, 6-10 rezultojnë të gjykuara në më pak se **87 ditë**.

**Në total për vitin 2019 janë gjykuar brenda këtij afati 183 çështje.**

Pra, janë gjithsej 659 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do t'i zbriten numrit prej 814 çështjesh të përlogaritura në raportin analitik, duke mbetur kështu 155 çështje të shyrtuara jashtë këtij afati, të llogaritur si standard minimal.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve për të cilat parashikohet standardi minimal kohor është 1465 dhe numrit total të çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohore cila nuk është më 814, por rezulton të jetë 155 çështje, ose rreth 10 % e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Sipas “*Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit*”, të miratuar me vendimin me Nr. 264, datë 21.11.2019 të KLGJ, përqindja matematikore prej 10 % përkon me nivelin e vlerësimit 5 (pesë) pikë (0-10% - 5 pikë).

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, në përcaktimin e nivelit të vlerësimit për këtë tregues, të dhënat statistikore analizohen duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit.

Referuar treguesit sasior, rezultoi se gjyqtari ka përfunduar në periudhën 3 vjeçare të vlerësimit në total 2017 çështje nga të cilat 1741 çështje, nga të cilat 1104 çështje janë me palë kundërshtare dhe 637 çështje pa palë kundërshtare, duke e tejkaluar kështu standardin sasior në fuqi<sup>119</sup>, me 654 çështje më shumë ose me thujse 145 %.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*plotësimi i standardeve minimale kohore*” në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se: “*Krahas afateve të parashikuara nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i çështjeve, sipas kategorive, cmoj se kam aftësi shumë të lartë për të respektuar afatet orientuese të miratuara për çdo kategori çështjesh, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara.*”

Kryetari i gjykatës e ka vlerësuar treguesin “*plotësimi i standardeve minimale kohore*” në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se: “*Në gjykatën administrative gjykohen çështje me karakter të ndryshëm nga njera-tjera, të cilat paraqesin vështiresi në gjykimin e tyre sepse kanë shumë problematika në vetvete, të cilat kërkojnë secila kohën e tyre. Pranë kësaj gjykate gjykohen çështje të cilat kërkojnë ekspertime dhe riekspertime dhe nuk mund të përfundojnë brenda 30 ditësh.*”

<sup>119</sup> Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, të ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja c), parashikohet se “*Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit administrativ, jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative*”.

*Afati 30 ditor i përcaktuar ne vendimin nr.261/2 datë.14.04.2010 i KLD-së, është objektivisht i pamundur, për shkak të numrit të lartë të çështjeve të shortuara dhe të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe për më tepër në periudhën e dhënë të vlerësimit.*

*Ngarkesa reale në punë është mbi 2 – fishin e standartit minimal të miratuar . Ngarkesa në punë e shtohet edhe nga shqyrtimi i çështjeve pa palë kundërshtare si dhe gjykimi i kërkesave për sigurimin e padisë, të paraqitura së bashku me kërkesë – padinë, të cilat përbëjnë një ngarkesë reale në punë.*

*Në kohëzgjatjen e një procesi gjyqësor ndikon natyra e çështjes dhe kërkesat që palët paraqesin gjate zhvillimit të gjykimit,të cilat nuk mund të refuzohen me qëllimin që gjykimi të përfundoje në një kohë të shpejtë.*

*Gjithashtu edhe periudha e muajit gusht ndikon në kohëzgjatjen e çështjes”*

### **Konkluzioni**

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve që rezulton 10 % , përqindje që sipas Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 5 pikë si dhe faktin se gjyqtari e ka tejkaluar standardit sasior të zbatueshëm në masën 145 %, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 10% i çështjeve jashtë standardit minimal 87/ditor, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikundër është treguesi sasior i punës së tij (tejkalim i standardit sasior me 145 %).*

### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi (1 muaj) sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e gjatë se standardi për një prej tre kategorive të çështjeve. Krahasimi për efekt të vlerësimit, do të bëhet duke iu referuar standardit minimal kohor 87 ditë për çështjet me palë kundërshtare, referuar arsyetimit të bërë më sipër në treguesin 2.A.b.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje (i) për kategorinë “Çështje administrative me palë kundërshtare” është **60.75 ditë** (më e shkurtër se standardi minimal kohor 87 ditë); (ii) për kategorinë “Çështje administrative pa palë kundërshtare” është **8.2 ditë** (më e shkurtër se standardi minimal kohor ne fuqi prej 1/muaj si dhe standardi minimal kohore prej 87); dhe (iii) për kategorinë “Marrëdhënie pune” është **86 ditë** (më e shkurtër se standardi minimal kohor 87/ditë).

Duke iu referuar arsyetimit të mësipërm lidhur me standardin minimal që duhet të gjejë zbatim për gjykimin e të gjitha çështjeve administrative, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për tre kategoritë e çështjeve, është më e shkurtër se afati 87 ditor.

Për sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të tre kategoritë, me afatin 87 ditor të pranuar si një standard minimal për një gjykim administrativ, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se ky afat për të gjitha kategoritë e çështjeve, e cila, sipas Metodologjisë, pikëzohet me 5 pikë.

Gjyqtari dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin maksimal.

## **KONKLUZIONI**

Mbështetur në të njëjtën analizë si në treguesin më sipër (*treguesi "2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore"*), duke konsideruar afatin 87 ditor si standard minimal kohor për efekte të krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton se koha mesatare është më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve, që sipas Metodologjinë e Pikëzimit pikëzohet me 5 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve për gjykimin administrativ dhe për këtë arsye gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.*

### **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (1741), me numrin e çështjeve të caktuara brenda periudhës së vlerësimit (1851), është 94%, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 8 pikë (mbi 93-99 %- 8 pikë).

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se bazuar në të dhënat statistikore mbi çështjet që janë caktuar për periudhën e vlerësimit, rezulton se kanë përfunduar në masën mbi 99% të çështjeve brenda një vit. Po kështu, kryetari lidhur me këtë tregues parashtron se në rendimin e çështjeve me palë kundërshtare duhet vlerësuar se ka disa çështje që janë pezulluar dhe për këtë arsye gjykimi nuk ka përfunduar.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *"Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli".* Sipas pikës 3 shkronja "c", të Aneksit

1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i shkallës së parë i seksionit administrativ, duhet të gjykojë jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative.

Referuar standardit sasior në fuqi, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 150 çështje me palë kundërshtare në vit apo 450 çështje në tre vjet. Në rastin konkret, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar 1104 me palë kundërshtare, ose 654 çështje më shumë seç është e përcaktuar në Vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së, duke e kaluar standardin sasior me thujse 145 %.

## KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit është 94 %, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 8 pikë, pasur parasysh se gjyqtari e ka tejkaluar në çdo vit standartin minimal të ngarkesës në punë, mesatarisht me rreth 146 %, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet maksimalisht, me 10 pikë

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 10 pikë, pasi rendimenti prej 94% i përfundimit të çështjeve ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikundër është treguesi sasior i punës së tij (1741 çështje të përfunduara, nga të cilat 1104 çështje janë me palë kundërshtare), duke qenë se në çdo vit ai e ka tejkaluar standartin minimal sasior, mbi 50 %, konkretisht me 145 %.*

### **2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 42 pika 3 të ligjit nr. 49/2012, është si më poshtë:

- (i) Për çështjet e tjera të kategorisë “Çështje me palë kundërshtare” rezulton koha mesatare e arsyetimit është 2.2 ditë, **më i shkurtër se** afati procedural i posaçëm të parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.
- (ii) Për çështjet e tjera të kategorisë “Çështje pa palë kundërshtare” rezulton koha mesatare e arsyetimit është 1.5 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.
- (iii) Për çështjet e tjera të kategorisë “Marrëdhënie pune”<sup>120</sup> rezulton koha mesatare e

<sup>120</sup>Në llogaritjen e kohës mesatare të arsyetimit të vendimit për këtë kategori janë përfshirë çështjet e pasqyruar në tabelën nr.3 të viteve 2017, 2018 dhe 2019, si dhe çështjet me nr. rendor 5, 11 dhe 83 me objekt “Dëmshpërblim page” të pasqyruar gabimisht nga gjykata në tabelën nr.1, viti 2017. Po kështu, konstatohet se në tabelën nr.3, viti 2019, në çështjen me nr. rendor 2, gabimisht koha e arsyetimit të vendimit është pasqyruar 150 ditë, ndërkohë që nga të dhënat statistikore rezulton se vendimi është dhënë në datë 21.03.2019 dhe është dorëzuar i arsyetuar në datën 05.04.2019, pra 15 ditë dhe jo 150 ditë.

arsyetimit është 2.3 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke argumentuar se bazuar në të dhënat statistikore, si edhe regjistrin e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara në sekretari, rezulton se “*respektimi i afatit të dorëzimit nga ana e Magjistratit {...} përmireson mesataren e gjykates për këto tregues*”

Sa më sipër, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*” dhe gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, lidhje me treguesin “*Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar*” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

## **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.**

***2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.***

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe të dhënave që pasqyrohen në Raportin Analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikatat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Referuar sa më sipër, për vlerësimin e këtij treguesi, në mungesë të të dhënave për numrin e seancave për të gjitha çështjet, të dhënat e analizuarat i referohen 19 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat janë çështje me palë kundërshtare. Referuar Raportit Analitik, rezulton se rezulton se në 19 dosjet e përzgjedhura me short (*duke përjashtuar 2 çështjet pa palë kundërshtare*) rezulton se janë zhvilluar **75 seanca gjithsej, nga të cilat 37 seanca përgatitore dhe 38 gjyqësore.** Numri mesatar i seancave gjyqësore është **2 seanca**.



Gjyqtari në vetëvlerësimin e saj, lidhur me këtë tregues ka parashtruar se ka bërë përpjekje për të shmangur kur është e mundur seancat joproduktive, duke i dhënë vëmendje të veçantë njoftimeve të rregullta, në raport me afatin tërësor të gjykimit, si edhe mendimit të palëve për t'ju siguruar afatin e arsyeshëm, në respekt të procesit të rregullt ligjor.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave gjyqësore jo produktive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se Gjyqtari subjekt vlerësimi ka mbikëqyrur dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët. Gjyqtari ka disponuar me vendime të ndërmjetme për konstatimin e padisë me të meta, vendimi është shoqëruar me paralajmërimin se në rast të mosplotësimit të të metës brenda afatit, padia do të kthehet me të meta.

Shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe të ndryshme. Konkretisht evidentohet se si shkaqe të shtyrjes së seancave janë me qëllim që palët të njihen me aktin e ekspertimit, njoftimin rregullisht të ekspertes, palës paditëse apo personit të tretë, me qëllim komunikimin e palëve në mungesë të vendimit të shtesës apo saktësimin të objektit të padisë, me qëllim paraqitjen e palës përfaqësuesit të palës paditëse, për shkak të mosformimit të trupit gjykues, për t'u dhënë kohë palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim si dhe në dy raste për dhënien e vendimit të arsyetuar.

Gjithashtu rezulton se në rastet e shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, kur ligji parashikon të tilla (afati 5 ditor për dhënien kohë palëve për diskutimin përfundimtar). Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave për kryerjen e veprimeve përgatitore, seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, konstatohet në të gjitha dosjet e analizuarat respektimi i afatit ligjor për caktimin e seancave (afati 7 ditor për zhvillimin e veprimeve paraprake sipas parashikimeve të nenit 25 të Ligjit nr.49/2012, afati 15 ditor për caktimin e seancës gjyqësore sipas nenit 27 të Ligjit nr.49/2012, afatet 10 ditore për dhënien kohë palës paditëse për plotësimin e të metave dhe palës së paditur për paraqitjen e prapësimeve dhe provave pas njoftimit të padisë).

Konstatohet se nga ana e gjyqtarit merren të gjitha masat me qëllim shmangien e seancave joproduktive dhe numri mesatar i seancave në masën 2 seanca vjen për shkak të respektimit të detyrimit ligjor për dhënien e kohës palëve për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare.

Gjyqtari dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

## **KONKLUZIONI**

Referuar sa më sipër, për treguesin *“Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”*, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 19 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është **2 seanca** dhe gjyqtari në të gjitha çështjet (me palë kundërshtare) ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2 seanca dhe në çdo rast gjyqtari ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.*

### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke zhvilluar veprimet përgatitore në dhomë këshillimi brenda një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short, dhe në çdo rast brenda afatit ligjor 7 ditor nga data e shortit, në përputhje me parashikimet e nenit 25 pika 1 të ligjit nr.49/2012.

Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtari kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25 pika 1 të Ligjit nr.49/2012 duke disponuar për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen e tyre brenda afatit ligjor 10 ditor, duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin për mospranimin e tyre në rast të mosparaqitjes në afat, në respektim të parashikimeve të nenit 25 pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 49/2012. Pas kalimit të afatit për paraqitjen nga pala e paditur të prapësimeve me shkrim dhe provave, gjyqtari ka zhvilluar veprimet përgatitore duke evidentuar në procesverbal veprimet e kryera për verifikimin e njoftimeve drejtuar palës së paditur, datën e komunikimit të tyre, paraqitjen ose jo të prapësimeve me shkrim nga pala e paditur brenda afatit të caktuar nga gjykata, liston provat shkresore të paraqitura nga pala si dhe disponon për caktimin e seancës përgatitore. Në dosjet e vëzhguara, në çështjet me palë kundërshtare është vlerësuar nevoja për zhvillimin e seancës përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Në disa raste në të cilat kërkesëpadia përmban edhe kërkesën për sigurimin e padisë duke pezulluar efektet e aktit administrativ, gjyqtari ka caktuar, seancë gjyqësore të posaçme për shqyrtimin e kërkesës, duke e caktuar këtë seancë brenda afatit 5 ditor të përcaktuar në nenin 28, pika 3 të ligjit nr. 49/2012.

Në një çështje e cila i përket kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtare, me objekt “Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit”<sup>121</sup>, me urdhrin “Për shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit” gjykata ka disponuar për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi. Konstatohet se pavarësisht se është shqyrtuar çështja mbi bazën e akteve të paraqitura nga ana e palës kërkuese, është mbajtur procesverbal (me sekretare gjyqësore) për evidentimin e provave mbi të cilat gjyqtari disponon në lidhje me kërkesën. Seanca në dhomë këshillimi nuk është regjistruar audio, por është mbajtur procesverbali me shkrim, në të cilin janë pasqyruar se bashkëlidhur kërkesës janë paraqitur aktet të cilat janë listuar në mënyrë kronologjike. Në përfundim pasi ka shqyrtuar këto akte, gjykata ka vendosur për pranimin e kërkesës.

<sup>121</sup> Vendimi nr.ska, datë 20.01.2017

Seancat përgatitore janë zhvilluar në mënyrë korrekte dhe të plotë duke evidentuar në çdo rast verifikimin e paraqitjes së palëve, relatimin lidhur me aktet e njoftimit të palëve dhe paraqitjen ose jo të tyre. Në rastet kur seanca përgatitore është zhvilluar në mungesë të palës së paditur, gjyqtari, pasi ka dëgjuar palën paditëse, ka relatuar prapësimet me shkrim të paraqitura nga të paditurit dhe provat shkresore që janë paraqitur nga pala në mungesë, duke disponuar me vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë. Në seanca përgatitore janë shqyrtuar dhe është disponuar me vendim të ndërmjetëm, duke disponuar për zhvillimin e tyre në mungesë të palëve të cilat nuk janë paraqitur pa shkaqe të arsyeshme, për plotësimin e të metave të padisë, për komunikimin e palës paditëse kërkesën për shtim apo saktësimi të objektit të padisë, për shtimin e ndërgjyqësisë etj.

Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 158/b të K.Pr.C, në çështjet me palë kundërshtare, gjyqtari ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, e cila në çdo rast, në 21 çështjet e vëzhguara është caktuar brenda afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012. Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (i arsyetuar në çdo rast si akt më vetë), përmban elementët e përcaktuar në nenin 27 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore sipas përcaktimeve të nenit 27 pika 3 të ligjit nr.39/2012.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio. Seancat gjyqësore rezulton të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.C dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni për palët që nuk janë paraqitur; deponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; deklarin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; administrimin e provave; drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit; dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat; deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; disponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare duke i dhënë kohë sipas afatit procedural të përcaktuar në nenin 302 të K.Pr.C; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në disa raste, gjendet i administruar vendimi i arsyetuar lidhur me disponimin më vendim të ndërmjetëm për kërkesën për sigurimin e padisë apo për kthimin e padisë me të meta.

Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesa të papërfillshëm. Veprimet përgatitore dhe seancat përgatitore janë dokumentuar rregullisht dhe në mënyrë të plotë në procesverbalin e mbajtur nga sekretarja gjyqësore ndërsa seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio.

Gjyqtari dhe kryetari e kanë vlerësuar treguesin “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” në shkallë shumë të lartë.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.*

### **2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.**

#### **2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori ndërthurur me veprimet procedurale të gjykatës. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të gjitha dosjet e vëzhguara duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes fillon me aktin e shortit, padinë, aktet e përfaqësimit, provat e paraqitura nga pala paditëse, prapësimet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur (*kur prapësimet janë paraqitur me shkrim*), kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, aktet e njoftimit, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, procesverbalin për kryerjen e veprimeve përgatitore, procesverbalet e seancave përgatitore dhe gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të zbardhura, vendimin gjyqësor përfundimtar. Mënyra e renditjes së akteve në dosje e bën atë lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë.

Gjyqtari e ka vlerësuar treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se: “Ashtu si përmbajtja e vendimit gjyqësor, e cila duhet të jetë e strukturuar sipas përcaktimeve të nenin 310 të Kodit të Procedurë, vlerësoj se kam aftësi shumë të lartë për të renditur aktet e dosjes gjyqësore, në mënyrë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme.”

## KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerëohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.*

### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*padia, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e dokumentimit të veprimeve paraprake, seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet gjyqësore përfundimtare dhe të ndërmjetme kur ato janë zbardhur me vete, vendimet për pranimin e ankimit*).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Gjyqtari e ka vlerësuar treguesin “*saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes*” në shkallë shumë të lartë.

## KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit

KRITERI

AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### 3.A Etika në punë

##### 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtarin {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit vitet 2017-2019, ndaj gjyqtarit rezulton të jenë paraqitur 4 (katër) ankesa për të cilat, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.2819/1 prot., datë 05.10.2022, nr.1237/1 prot., datë 20.06.2023, nr.2434/1 prot., datë 07.10.2022 dhe nr.2319/1 prot., datë 16.09.2022 ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

I- Ankesa e Elvana Spaho, depozituar ankesa pranë KLGJ-së me nr. 720 prot., datë 05.02.2019 dhe regjistruar pranë ILD-së me nr. 879 prot., datë 03.06.2020. Me vendimin nr.2819/1 prot., datë 05.10.2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: *“Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj.Elvana Spaho”*.

II- Ankesa e Erjon Braçe, depozituar ankesa pranë KLGJ-së me nr. 4328 prot., datë 26.08.2019 dhe regjistruar pranë ILD-së me nr. 1554 prot., datë 08.07.2020. Me vendimin me nr.1237/1 prot., datë 20.06.2023 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka disponuar *“Për arkivimin pas verifikimit të të ankesës së paraqitur nga ish-Zëvendëskryeministrit të Republikës së Shqipërisë Z.Erion Braçe, ndaj magjistratit z. {...} dhe mbyllje pa vendim përfundimtar, përse i përket pretendimeve ndaj ish-magjistratit z.S.H.*

III- Ankesa e Agim Ismaili, përcjellë ankesa për kompetencë nga Ministria e Drejtësisë me nr.3013 prot., datë 22.10.2018 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Drejtësisë me nr.994 prot., datë 17.02.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur me vendimin nr.2319/1 prot., datë 16.09.2022 *“Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.*

IV- Ankesa e subjekti “Borshi” shpk, depozituar ankesa pranë KLGJ-së me nr. 3727 prot., datë 10.07.2019 dhe regjistruar pranë ILD-së me nr. 1248 prot., datë 18.06.2020. Me vendimin me nr.2434/1 prot., datë 07.10.2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shoqëria “Borshi” shpk.

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtarit subjekt vlerësimi.

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarit në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, etika e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.*

### **3.B Integriteti i gjyqtarit**

#### ***3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD 4 (katër) ankesa, të trajtuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.2819/1 prot., datë 05.10.2022, nr.1237/1 prot., datë 20.06.2023, nr.2434/1 prot., datë 07.10.2022 dhe nr.2319/1 prot., datë 16.09.2022, në të cilat është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtarit {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 2807/1 prot. datë 09.07.2021, rezulton se: *“Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimi e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për këto subjekte (ndër të cilët edhe gjyqtari subjekt vlerësimi {...}) rezulton se: a) Deklaratat e interesave private Periodike/Vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore. b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit. c) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave”.*

Gjyqtari, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel shumë të lartë. I njëjti vlerësim është dhënë edhe nga Kryetari i Gjykatës.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

## **KONKLUZIONI**

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

### **3.C Paanësia e gjyqtarit**

#### **3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Asnjë prej dokumenteve ligjorë të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të pakicave apo të të miturve. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor,



akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i Kryetarit.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, janë paraqitur 9 (nëntë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, nga të cilat nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e tij nga gjykimi. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtari ka paraqitur 22 (njëzet e dy) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 17 (shtatëmbëdhjetë) janë pranuar.

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar treguesin “numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” si të pakonsiderueshëm.

## **KONKLuzioni**

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, vlerësohet se ky numër është “I pakonsiderueshëm” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### 4.A Aftësia e komunikimit.

##### 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor si dhe në rastet e ndërhyrjes së saj për shmangien e seancave joproductive, konstatohet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre apo në lidhje me dispononim e gjykatës me vendime të ndërmjetme.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar si dhe duke evidentuar në mënyrë të qartë aktin që kërkohet nga të tretët.

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

##### KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

#### **4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

**Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar.**

**4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

#### **4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtari

ka komunikim korrekt me administratën gjyqësore, në funksion të krijimit të një ambienti pune harmonik dhe produktiv.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.**

##### ***4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, konkretisht shkresës nr. 347/1 prot., datë 28.07.2021 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë pjesëmarrësit në 13 (trembëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 25 ditë trajnimi.

#### **KONKLUZIONI**

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 13 aktivitete trajnuese të shtrira në 25 ditë trajnimi, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve 15-120 ditë dhe pikëzohet me 20 pikë.*

##### ***4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe dosjes personale të gjyqtarit {...}, evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues si më poshtë vijon:

Në datë 09.01.2023 gjyqtari me shkresën e protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.106 prot., datë 09.01.2023, në kuadër të procesit të vlerësimit periodik ka paraqitur dy dokumente, konkretisht vërtetimin e lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës mbi mentorimin e disa studentëve të Shkollës së Magjistraturës si dhe ftesë për pjesëmarrje në konferencën me temë “13 vjet eksperiencë e politikës së Konkurrencës në Shqipëri, aspekte nga ligji, ekonomia dhe biznesi.”

Me vërtetimin me nr.26 prot., datë 09.01.2024, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës pasqyrohet se z. {...} është angazhuar në cilësinë e magjistratit udhëheqës të praktikës profesionale të vitit të dytë të akademik në Shkollën e Magjistraturës për periudhën 2017-2019. Për periudhën e sipërcituar z. {...} ka udhëhequr praktikën profesionale të kandidatëve për magjistrat Florin Demollari, Shkelzen Liçaj, Olti Skrame, Arjeta Lika dhe Marjola Beluli.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se pikëzimi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë, dhe 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit.

Gjyqtari, në formularin e integruar të vlerësimit është shprehur se “Kam shprehur gadishmërinë time për t’u përfshirë në listën e gjyqtarëve udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, si dhe gjatë stazhit profesional të tyre.”

## **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke qenë se gjatë periudhës së vlerësimit, me vërtetimin nr.26, datë 09.01. 2024 të Shkollës së Magjistraturës rezulton se gjyqtari është angazhuar në udhëheqjen e kandidave magjistratë për periudhën 2017-2020, ai pikëzohet me 5 pikë.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” rezulton angazhimi i gjyqtarit dhe për pasojë pikëzohet me 5 pikë.*

### **4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) nga dosja personale e gjyqtarit apo të dhëna nga burimet e vlerësimit, në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në lidhje me këtë tregues gjyqtari në datë 09.01.2024 me shkresën e protokollur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.106 prot., datë 09.01.2024, në kuadër të procesit të vlerësimit periodik ka paraqitur dy dokumente, konkretisht vërtetimin e lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës mbi mentorimin e disa studentëve të Shkollës së Magjistraturës si dhe ftesë për pjesmarrje në konferencën me temë *“13 vjet eksperiencë e politikës së Konkurrencës në Shqipëri, aspekte nga ligji, ekonomia dhe biznesi.”*

Gjithashtu, në datë në lidhje me këtë tregues gjyqtari në datë 11.01.2024 me shkresën e protokollura pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.165 prot., datë 11.01.2024, në kuadër të procesit të vlerësimit periodik ka paraqitur dokumente, që i përkasin pjesmarrjen e tij si gjyqtar në Konferencën me temë: *“Ëorkshop on the European relating to Asylum for Eastern Balkan judges”*, në datat 09-10 tetor 2017”, dokumentacion i cili është administruar dhe është bërë pjesë e dosjes së vlerësimit.

Gjyqtari, në formularin e integruar të vlerësimit është shprehur se *“Çmtoj se përmirësimi i sistemit të drejtësisë realizohet më së miri duke kryer detyrën me korektësi dhe përkushtim, duke respektuar parimet themelore dhe përmbushur detyrimet proceduriale, objekt të cilin mendoj se e kam arritur.”*

Kryetari i gjykatës ka deklaruar se *“Gjyqtari ka marrë pjesë në Ëorkshop-in e organizuar nga EASO (Zyra Mbeshtetese Europiane per Azilin), organizem prane Bashkimit European, në Mal te Zi. Igallo, në datat 09.10.2017 dhe 10.10.2017 me teme : " Per te Drejten Europiane per Azilin me gjyqtaret e vendeve te Ballkanit Perendimor”.*

Lidhur me këtë tregues në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se: *“Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike”.*

Në lidhje me dokumentat e paraqitura nga gjyqtari në kuadër të procesit të vlerësimit, që vërtetojnë pjesmarrjen e tij në një Ëorkshop të organizuar nga një organizatë ndërkombëtare, vlerësoj se këto të dhëna tregojnë angazhimin e gjyqtarit në një aktivitet trajnues jashtë Shkollës së Magjistraturës, të zhvilluar nga një organizatë ndërkombëtare, në rang rajonal dhe nuk tregojnë kontributi i tij personal në këtë veprimtari ndërinstitucionale që kanë pasur si qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë, psh fjalime, pjesmarrje në konferenca shkencore, duke paraqitur një temë përkatëse, pjesmarrje në programet e edukimit të komunitetit, etj. Pra vlerësohet si pjesmarrja në veprimtari ndërinstitucionale, pjesmarrja aktive e gjyqtarit për përmirësimin e sistemit gjyqësor, duke dhënë kontributin e tij dhe jo thjeshtë pjesmarrje, për të përfutuar vetë gjyqtari nga një veprimtari e tillë, duke mos sjellë një kontribut konkret.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, nga relatorja fillimisht u vlerësua se për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij.

Pas njoftimit të projektraporti të vlerësimit, gjyqtari paraqiti kundërshtime lidhur me këtë tregues dhe kërkoi pikëzim maksimal, duke pretenduar se ka kryer veprimtari ndërinstitucionale. Për të provuar këtë fakt, gjyqtari paraqiti vërtetimin nr.310 prot., datë 06.03.2024 të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, sipas të cilës vërtetohet se për periudhën 2017-2019 gjyqtari ka dhënë kontributin në propozimin e temave të aktiviteteve trajnuese, kontribut ky që përkon me fazën e përgatitjes së kalendarit të aktiviteteve trajnuese për Programin e Trajnimit Vazhues në Shkollën e Magjistraturës.

Duke marrë parasysh kundërshtimet dhe provën e paraqitura nga ana e gjyqtarit, me anë të cilës provohet kontributi i tij në propozimin e temave për aktivitetet trajnuese në Shkollën e Magjistraturës brenda periudhës së vlerësimit ky tregues vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij.

#### **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari {...} të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.C.ç Publikimet ligjore akademike.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

Në formularin e vetëvlerësimit gjyqtari është shprehur se: “Çmuj se arsyetimi i çdo vendimi gjyqësor është në thelb një punim ligjor dhe akademik më vehte”.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

*Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtarit për këtë arsye gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

## NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Nivelin e vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm

## REKOMANDIME



Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për t rajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstytucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të tij për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA 1**  
**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE**  
**NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}**  
**PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019**

<b>1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>	
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>	
<b>Treguesit</b>	<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë</b>	<b>Pikët</b>	<b>Të dhëna për metodologjinë</b>		
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3.Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b>	

		2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	0-10 %	15	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 3 pikë

<b>ngarkesën në punë</b>		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit			31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e

					çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	<b>Tej standardit :</b> Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	15	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin

					procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	<b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë

					Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarit :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë

		4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI			
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>93</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>	<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>	



<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparenca e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	15-120 ditë	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

		profesionale të gjyqtarit			
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>			<b>395</b>		
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>			<b>Shkëlqyeshëm</b>		

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**